

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 9.06.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Totali	100	

Problemi 1

Në vijim janë draft pasqyrat e pozitës financiare të Dua sh.a, Rita sh.a dhe Bebe sh.a me 31 maj 2018.

	Dua	Rita	Bebe
	€'000	€'000	€'000
Pasuritë			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	600	482	300
Investimet (1)	<u>288</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	888	482	300
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	120	110	100
Të arkëtueshmet tregtare	200	190	180
Paraja në bankë	<u>80</u>	<u>70</u>	<u>60</u>
	<u>400</u>	<u>370</u>	<u>340</u>
Total pasuritë	1,288	852	640
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila	300	200	100
Premia e aksioneve	320	-	-
Fitimet e mbajtura	<u>256</u>	<u>194</u>	<u>115</u>
Total ekuiteti	876	394	215
Detyrimet			
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
10% Notë krediti	120	-	250
12% Notë krediti	<u>-</u>	<u>400</u>	<u>-</u>
	120	400	250
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	<u>292</u>	<u>58</u>	<u>175</u>
Total detyrimet	<u>412</u>	<u>458</u>	<u>425</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,288	852	640

Informata shtesë

(1) Shifra e investimeve të Dua sh.a është si në vijim:

Data e blerjes

detajet

1 qershor 2016	280,000 aksione të ekuitetit në Rita sh.a për një konsideratë në para prej €224,000 kur fitimet e mbajtura ishin €94,000.
1 shtator 2017	40% të aksioneve të ekuitetit në Bebe sh.a për €0.80 për aksion kur fitimet e mbajtura ishin €55,000.

- (2) Vlerat e drejta të pasurive neto të Rita sh.a's me 1 qershor 2016 ishin të barabarta me vlerat bartëse të tyre me përjashtim të një fabrike. Vlera e saj e drejtë ishte më e ulët se vlera bartëse për €6,000. Fabrika kishte jetë të mbetur të përdorimit ekonomik prej 3 viteve me 1 qershor 2016.

Korigjimet e vlerës së drejtë nuk janë inkorporuar në librat e Rita sh.a.

- (3) Në periudhën pas blerjes, Dua sh.a shiti mallra tek Rita sh.a dhe Bebe sh.a për €20,000 dhe €15,000 respektivisht. Dua sh.a aplikon një marzhë në çmimin shitës prej 20% në të gjitha shitjet e saj. 75% dhe 90% e mallrave të shitura tek Rita sh.a dhe Bebe sh.a respektivisht, janë shitur më pastaj tek klientët e tyre deri me me 31 maj 2018.
- (4) E përfshirë në të arkëtueshmet tregtare të Dua sh.a ishte një shumë prej €10,000 të cilën ia kishte borxh Rita sh.a. Megjithatë, shuma e përfshirë në të pagueshmet tregtare të Rita sh.a ishte €8,000. Diferenca ishte për shkak të parasë së paguar nga Rita sh.a e cila nuk ishte regjistruara në librat e Dua sh.a.
- (5) Zëri i mirë në Rita sh.a dhe investimi në Bebe sh.a ishin dëmtuar për €2,000 dhe €1,000 respektivisht në vitin deri me 31 maj 2018.
- (6) Është politikë e grupit që të vlerësoj interesin jo-kontrollues duke përdorur vlerën e tij të drejtë në datën e blerjes së degës. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues me 1 qershor 2016 ishte €96,000.
- (7) Përveç nëse është thënë ndryshe, supozo që të gjitha fitimet dhe humbjet ndodhin njëtrajtësisht përgjatë vitit.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Dua me 31 maj 2018.

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

1. Grupi Dua

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 maj 2018

€'000

Pasuritë

Pasuritë jo-qarkulluese

Prona, fabrika dhe paisjet 600+482 - 6 +4 (L12)

1,080

Zëri i mirë 32 L11 - 2 (dëmtimi)

30

Investimet në shoqëri L13

86.88

1,196.88

Pasuritë qarkulluese

Stoqet 120 + 110 - 1L12

229

Të arkëtueshmet tregtare 200 + 190 - 10 (brenda grupit)

380

Paraja në bankë 80 + 70 + 2 (paraja që nuk është regjistruar)

152

761

Total pasuritë

1,957.88

Ekuiteti dhe detyrimet

Ekuiteti

Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila

300

Premia e aksioneve

320

Fitimet e mbajtura L12

349.28

969.28

Interesi jo-kontrollues L14

126.6

Total ekuiteti

1,095.88

Detyrimet

Detyrimet afatgjata

10% Nota krediti

120

12% Notë krediti

400

520

Detyrimet afatshkurtëra 292 + 58 - 8 (brenda grupit)

342

Total detyrimet

862

Total ekuiteti dhe detyrimet

1,957.88

Llogaritjet**L11 - Zëri i mirë**

	€'000	€'000
Kosto e investimit	224	
VD e IJK në blerje	<u>96</u>	
		320
VD e pasurive neto në blerje:		
Kapitali aksionar	(200)	
Fitimet e mbajtura	(94)	
Korigjimet e VD	<u>6</u>	
		<u>(288)</u>
Zëri i mirë		32

Struktura e grupit

Dua sh.a në Rita sh.a $280,000 / (200,000 / 0.5) = 70\%$

Interesi jo-kontrollues $100 - 70 = 30\%$

Dua sh.a në Bebe sh.a = **40%**

L12 - Fitimet e mbajtura

	Dua sh.a €'000	Rita sh.a €'000	Bebe sh.a €'000
Sipas pyetjes	256	194	115
Minus: para blerjes		<u>(94)</u>	<u>(55)</u>
		100	60
Zhvl. në VD-në e korigjuar (2/3x6)		<u>4</u>	
		104	60
Pjesa e grupit në:			
Rita sh.a 70% x 104	72.8		
Bebe sh.a 40% x 60	24		
Dëmtimet [(70% x 2) + 1]	(2.4)		
FPR në mallrat e shitur tek:			
Rita sh.a 20% x 20 x 25%	(1)		
Bebe sh.a 20% x 15 x 10% x 40%	<u>(0.12)</u>		
	349.28		

L13 - Investimet në shoqëri - Bebe sh.a

	€'000
Kosto e investimeve $40\% \times 100 / 0.5 \times \text{€}0.8$	64
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura para blerjes L12	24
Dëmtimi	(1)
FPR L12	<u>(0.12)</u>
	86.88

L14 - Interesi jo-kontrollues

VD në blerje	96
Pjesa e fitimeve pas blerjes $30\% \times 104$	31.2
Dëmtimi i zëri të mirë $30\% \times 2$	<u>(0.6)</u>
	126.6

Problemi 2

a) Informatat në vijim kanë të bëjnë me stoqet e Ana sh.a me 31 dhjetor 2017.

Lënda e parë - 300 kg

Kosto për kg	€60
Kosto aktuale për kg	€75

Puna në progres - 150 njësi

Kosto për njësi:	
Materialet	€150
Puna	€195
Shpenzimet e prodhimit	€300

Mallrat e përfunduara (gjendje të mirë) - 400 njësi

Kosto për njësi:	
Materialet	€450
Puna	€450
Shpenzimet e prodhimit	€300

Mallrat e përfunduara (dëmtuara) 10 njësi

Kostot e riparimit për njësi	€700
------------------------------	------

Çmimi shitës për njësi i mallrave të përfunduara (përfshirë mallrat e dëmtuara pas riparimit)	€1,800
---	--------

Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes për njësi	€300
---	------

Kërkohet:

Llogarite vlerën bartëse të stoqeve qe duhet të paraqitet në pasqyrën e pozitës financiare të Ana sh.a me 31 dhjetor 2017. (10 pikë)

b) Oxa sh.a kishte saldo të një kontratë të ndërtimit prej €8,250,000 e cila përbëhej nga zërat në vijim:

	€
Kosto e ndodhura deri me datë	42,000,000
Vlera e kontratës e faturuar (puna e çertifikuar) deri me datë	33,750,000

Kontrata filloi me 1 janar 2017 dhe është për një çmim fiks prej €75 milion. Kostot e mbetura për përfundimin e kontratës me 31 dhjetor 2017 janë vlersuar në €18 milion. Është politikë e grupit që të përlllogaris fitimet nga kontrata e ndërtimit duke u bazuar në shkallën e kompletimit, e cila është puna e çertifikuar si përqindje e çmimit të kontratës.

Kërkohet:

- i) Trego shumat e kostove të shitjeve të ndodhura deri me datë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (4 pikë)**
- ii) Llogariti shumat e papaguara nga klientet e kontraktuar me 31 dhjetor 2017. (2 pikë)**
- iii) Shpjego katër (4) kushtet që duhet të përmbushen gjatë përcaktimit nëse rezultati i një kontrate ndërtimi në rastin e një kontrate me çmim fiks mund të vlerësohet me besueshmëri. (4 pikë)**

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

a) Shumat e stoqeve në pasqyrën e pozitës financiare të Ana sh.a me 31 dhjetor 2017:

	Kosto/njësi		VNR/ njësi	Vlera në PFP
<i>Mallrat e përfunduara - gjendje të mirë</i>	Materialet 450		ÇSH 1,800	€1,200 x 400
	Puna 450		Sh. e shitjes (300)	= €480,000
	Shpenzimet e prodhimit <u>300</u>		1,500	
	1,200			
<i>Mallrat e përfunduara - Dëmtuar</i>	€1,200		ÇSH 1,800	€800 x 10
			Sh. e shitjes (300)	= €8,000
			K.e ripar. <u>(700)</u>	
			800	
<i>PP</i>	Materialet 150		ÇSH 1,800	€645 x 150
	Puna 195		Sh. e shitjes (300)	= €96,750
	Shpenzimet e prodhimit <u>300</u>		Kosto deri në përfundim	
	645		(1,200 - 645) <u>(555)</u>	
			945	
<i>Lënda e parë</i>				€60 x 300
				= €18,000
				(10 pikë)

b)

i) Shuma e kostove të shitjeve të ndodhura:		€
Të hyrat deri me datë		33,750,000
Fitimi deri me datë 45% x 15,000,000*		<u>6,750,000</u>
Kosto e shitjes deri me datë		27,000,000
% e kompletimit 33,750,000/75,000,000		45%
*Total fitimi nga kontrata		
Total të hyrat nga kontrata		75,000,000
Kostot e ndodhura deri me datë	42,000,000	
Kostot e mbetura të vleresuara deri në përfundim	18,000,000	<u>(60,000,000)</u>
		15,000,000 (4 pikë)

ii) Shumat e papaguara nga klienti i kontraktuar:	€	
Kostot e kontratës deri me datë	42,000,000	
Fitimi deri me datë	<u>6,750,000</u>	
	48,750,000	
Situacionet e faturuara deri me datë	<u>(33,750,000)</u>	
Shumat e papaguara nga klienti i kontraktuar	15,000,000	(2 pikë)

iii) Kushtet që duhet të përmbushen janë:

- (a) të hyrat totale mund të maten me besueshmëri;
 - (b) është e mundshme që përfitimet ekonomike nga kontrata do të rrjedhin drejt entitetit;
 - (c) edhe kostot e kontratës deri në përfundim e edhe shkalla e kompletimiti në fund të periudhës raportuese mund të maten me besueshmëri; dhe
 - (d) kostot e atribuara të kontratës mund të indentifikohen qartë dhe maten me besueshmëri ashtu që kostot aktuale të kontratës të ndodhura mund të krahasohen me vleresimit e mehershme.
- (4 pikë)**

Problemi 3

(a) Era sh.a ndërtoi një fabrike me 1 mars 2017 me një kosto prej €20,000 në një tokë. Kushtet e lëjes së ndërtimit janë që Era sh.a do të duhet të 'kthej tokën në gjendjen që ishte më heret para se ndërtimi të fillonte'. Kosto e vlerësuar e kësaj pas 20 viteve do të jete €10,000. Era sh.a përdor një normë të skontimit prej 10%.

Faktori i skontimit për 10% në 20 vite është 0.149

Kërkohet:

Llogarite vlerën me të cilën fabrika do të njihet në pasqyrat financiare të Era sh.a me 28 shkurt 2018, duke dhënë shpjegime për vlerat. (5 pikë)

(b) Një lizingmarrës mori nën lizing një pasuri jo-qarkulluese me një kontratë të pa-anulueshme të lizingut për 5 vite duke filluar nga 1 prill 2016 detajet e së cilës janë si më poshtë:

- (i) Pasuria ka jetëgjatësi të dobishme ekonomike prej 8 vite.
- (ii) Qiraja është €42,000 në vit e pagueshme në fillim të periudhës kontabël (pagesa e parë me 1 prill 2016).
- (iii) Lizingmarrësi duhet të paguajë kostot e sigurimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë.
- (iv) Vlera e drejtë e pasurisë me 1 prill 2016 ishte €176,600 përderisa vlera e tanishme e pagesave minimale të lizingut ishte €189,500 në po të njejtën datë. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 12.5% në vit.

Kërkohet:

Përgaditi ekstraktet e pasqyrës së të ardhurave si dhe të pasqyrës së pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018, ashtu siç duhet të paraqiten në librat e lizingmarrësit. (6 pikë)

(c) Qëllimi i SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet*, është të përshkruaj kriteret për selektimin dhe ndryshimin e politikave të kontabilitetit së bashku me trajtimin në kontabilitet të ndryshimeve në vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet'.

Kërkohet:

- (i) Trego dallimin ndërmjet trajtimit në kontabilitet të 'një ndryshimi të politikës së kontabilitetit' dhe të një 'ndryshimi në vlerësimin kontabël' duke dhënë shembuj të një ndryshimi të politikës në kontabilitet dhe një ndryshimi në vlerësimin kontabël. (2 pikë)
- (ii) Në cilat rrethana ka arsye të ndryshimit të një politike të kontabiliteti? (2 pikë)

(d) Një divizion i një kompanie ka saldot e mëposhtme në pasqyrat e saja financiare:

	€
Zëri i mirë	7,000
Fabrika	9,500
Prona	23,000
Pasuritë e paprekshme	8,000
Pasuritë tjera neto	4,300

Pas një periudhe të vazhdueshme të humbjeve, shuma e rikuperueshme e divizionit vlerësohet të jetë €40,000. Një vlerësim i kryer së fundi për pronën tregoi se pronë ka vlerë prej €25,000. Pasuritë tjera neto përbëhen prej parave dhe të arkëtueshmeve sipas shumave të tyre të rikuperueshme. Kompania përdor modelin e kostos për vlerësimin e pronës, fabrikës dhe paisjeve.

Kërkohe:

Trego saldon e seciles prej të mëposhtmeve pas rishikimit nga dëmtimi:

- (i) Pronën**
- (ii) Fabrikën**
- (iii) Zërin e mirë**
- (iv) Pasuritë e paprekshme**
- (v) Pasuritë tjera neto** **(5 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 3

a) Era sh.a. duhet të ndajë një provizion për kostot e restaurimit me 28 shkurt 2018 si një detyrim që është krijuar kur është dhënë leja dhe kostot janë matur me besueshmëri.

Provizioni do të jetë për kostot në të ardhmen, prandaj duhet të skontohej në vlerën e tanishme përgjatë 20 viteve sipas kërkesave të SNK 37 provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente. Shuma duhet të shtohet tek vlera bartese e fabrikes dhe të zhvlerësohet përgjatë 20 viteve.

Ekstrakt i pasqyrës së të ardhurave për vitin e përfunduar me 28 shkurt 2018

	€
Zhvlerësimi	1,074.5
Kosto e financimit (10% x 1,490)	149

Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare me 28 shkurt 2018

Pasuritë jo-qarkulluese

Kostot e ndërtimit	20,000
Kostot e restaurimit (0.149 x 10,000)	<u>1,490</u>
Total kosto e e ndërtimit	21,490
Minus zhvlerësimi (21,490/20 vite)	<u>1,074.5</u>
Vlera bartese	20,415.5

Detyrimet afatgjata

Provizionet për ambientin (1,490 + 149)	1,639
---	-------

b) Ekstrakt i pasqyrës së të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 mars 2018

Kosto e financimit	13,678
Zhvlerësimi	35,320

Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare me 31 mars 2018

Pasuritë jo-qarkulluese

PFP (176,600 - 70,640)	105,960
------------------------	---------

Detyrimet afatgjata

Obligimet ndaj lizingut financiar	81,103
-----------------------------------	--------

Detyrimet afatshkurtëra

Obligimet ndaj lizingut financiar	42,000
-----------------------------------	--------

Llogaritjet

i) Obligimet ndaj lizingut financiar tabela

	Saldo fillim	Qiraja	total	interesi	Saldo fund
1 prill 16	176,600	(42,000)	134,600	16,825	151,425
1 prill 17	151,425	(42,000)	109,425	13,678	123,103
1 prill 18	123,103	(42,000)	81,103	10,138	91,241

ii) Ngarkesa e zhvlerësimit për vitin.

Kjo bazohet në më të shkurten e jetës së përdorimit të pasurisë dhe kohëzgjatjes së lizingut =176,600/5 =35,320

c) SNK 8

i) Politikat në kontabilitet janë parime specifike, baza, konventa dhe praktika që aplikohen nga një entitet gjatë përgaditjes dhe prezantimit të pasqyrave financiare. SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* kërkon që një ndryshim në politikën e kontabilitetit të aplikohet retrospektivisht, pra, aplikimin e politikës së re sikur të ishte aplikuar përherë.

Shembuj të ndryshimit në politikën kontabël përfshijnë:

- Një shpenzim që me heret është klasifikuar si kosto e shitjes tani klasifikohet si shpenzim administrativ.
- Stoqet që janë vlerësuar duke përdorur metodën FIFO tani vlerësohen me metodën e mesatarës së ponderuar.

Vlerësimet janë rezultat i informatave të reja që do të shpjen në ndryshim të aktiviteteve biznesore.

SNK 8 kërkon që një ndryshim në vlerësimet kontabël të aplikohet në mënyrë prospektive, pra aplikimi i një vlerësimi të ri ose vetëm në peridhën aktuale (p.sh borxhet e këqija) apo të dyjat edhe periudhën aktuale edhe të ardhshmet (p.sh jeta e përdorimit ose vlera e mbetur e pasurive jo-qarkulluese)

Asnjë ndryshim nuk aplikohet në periudhat e mëhershme.

Shembuj të ndryshimeve të vlerësimeve në kontabilitet përfshijnë:

- Ndryshimi i përqindjes së zhvlerësimit
- Ndryshimi i jetës së përdorimit
- Ndryshimi i vlerës së mbetur
- Ndryshimi në lejimet për dëmtimet e stoqeve apo borxhet e këqija.

ii) SNK 8 kërkon që pasi që të zhvillohen, politikat e kontabilitetit duhet të aplikohen në mënyrë konsistente dhe thekson që ndryshimi do të lejohet vetëm nëse:

- Kërkohe nga një SNRF tjetër IFRS (i ri apo rishikuar)
- Jep informata më relevante dhe të besueshme

d)

i) Prona -	23,000
ii) Fabrika -	6,894
iii) Zëri i mirë -	0
iv) Pasuritë e paprekshme -	5,806
v) Pasuritë tjera neto -	4,300

Llogaritjet

Total dëmtimi i NJGJP (€'000) $51,800 - 40,000 = 11,800$

	Shuma e Alokuar	Humbja nga dëmtimi	Vlera bartese pas dëmtimit
	€	€	€
Zëri i mirë	7,000	7,000	-
Fabrika	9,500	2,606	6,894
Prona	23,000	-	23,000
Pasuritë e paprekshme	8,000	2,194	5,806
Pasuritë tjera neto	<u>4,300</u>	<u>-</u>	<u>4,300</u>
	51,800	11,800	40,000

Shënim:

Prona dhe pasuritë neto nuk janë dëmtuar pasi që vlerat e tyre të tregut janë më të larta se vlerat e tyre bartëse.

Problemi 4

Informatat në vijim janë marrë nga pasqyrat financiare të Elsa sh.a.

Ekstrakt i pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 mars 2018	
	€'000
Fitimi para interesit dhe tatimit	981
Kosto financiare	<u>(108)</u>
Fitimi para tatimit	873
Shenzimet e tatimit	<u>(305)</u>
Fitimi për vitin	568
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Teprica e rivlerësimit të pronës, fabrikës dhe paisjeve	<u>418</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	986

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 mars

	2018	2017
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	11,250	10,500
Pasuritë e paprekshme	<u>500</u>	<u>452</u>
	11,750	10,952
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	840	1,125
Të arkëtueshmet tregtare	260	210
Investimet	38	18
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	<u>5</u>	<u>30</u>
	1,143	1,383
Total pasuritë	12,893	12,335
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e ekuitetit	6,000	5,250
Premia e aksioneve	1,800	1,425
Teprica e rivlerësimit	750	356
Fitimet e mbajtura	<u>2,011</u>	<u>3,369</u>
	10,561	10,400
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
Aksionet preferenciale (të ripagueshme)	760	600
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>		
Të pagueshmet tregtare	222	210
Tatimi	600	525
Dividenda e zakonshme e pagueshme	<u>750</u>	<u>600</u>
	1,572	1,335
Total ekuiteti dhe detyrimet	12,893	12,335

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 (ekstrakt)

	Fitimet e mbajtura	Teprica e rivlerësimit
	€'000	€'000
Saldo me 1 prill 2017	3,369	356
Dividenda e deklaruar	(1,950)	
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	568	418
Transfer nga teprica e rivlerësimit tek fitimet e mbajtura	<u>24</u>	<u>(24)</u>
Saldo me 31 mars 2018	2011	750

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- i) Gjatë vitit Elsa sh.a emetoi edhe aksione të zakonshme edhe aksione preferenciale për para.
- ii) Invesitimet e klasifikuara si pasuri qarkulluese mbahen në afat të shkurtër dhe mund të konvertohet në para menjëherë në shuma në të cilat janë paraqitur sapo një gjë e tillë të kërkohet.
- iii) Gjatë vitit, Elsa sh.a shiti fabrikën dhe paisjen e vjetër me një shumë bartëse prej €840,500 për €900,000. Total zhvlerësimi për vitin arriti shumën prej €1,100,000. Fabrika që kushtoi €50,000 është blerë me kredi. Shuma është e përfshirë në të pagueshmet tregtare.
- iv) Të pagueshmet tregtare përfshijne interesin e përlogaritur prej of €5,000 me 31 mars 2018 (2017: €10,000).
- v) Pasuritë e paprekshme kanë të bëjnë me kostot e zhvillimit të kapitalizuara në pajtim me SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*. Kostot në shumë prej €70,000 janë kapitalizua gjatë vitit.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e rrjedhes së parasë për Elsa sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 në pajtim me SNK 7 *Pasqyra e rrjedhes së arkës*. (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

Elsa sh.a

a) Pasqyra e rrjedhes së parasë për vitine përfunduar me 31 mars 2018

	€'000	€'000
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit	873	
Kosto e financiare	108	
Zhvlerësimi	1,100	
Amortizimi (L14)	22	
Fitimi nga shitja e PFP (900-840.5)	(59.5)	
Zvogëlim në stoqe (1,125-840)	285	
Rritje në të arkëtueshmet tregtare (210-260)	(50)	
Zvogëlim në të pagueshmet tregtare (L17)	(33)	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	2,245	
Interesi i paguar (L12)	(113)	
Tatimi në fitim i paguar (L11)	(230)	
Neto paraja nga operacionet		1,902.5
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Blerja e pronës, fabrikës dhe paisjeve (L13)	(2,222.5)	
Blerja e pasurive të paprekshme	(70)	
Arkëtimet nga shitja e pronës, fabrikës dhe paisjeve	900	
Neto paraja përdorur në aktivitetet investuese		(1,392.5)
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve të zakonshme (6,000+1,800)-(5,250+1,425)	1,125	
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve preferenciale të ripagueshme (760-600)	160	
Dividenda e paguar (L16)	(1,800)	
Neto paraja përdorur në aktivitetet financuese		(515)
Neto rritja e parave dhe ekuivalentëve në para		<u>(5.0)</u>
Paraja dhe ekuivalentët në para në fillim (30+18)		48
Paraja dhe ekuivalentët në para në fund (38+5)		43

L11		Tatimi në fitim	
	€'000		€'000
Paraja e paguar	230	Saldo fillim	525
Saldo fund	<u>600</u>	P/A	<u>305</u>
	830		830
L12		Kosto e financiare	
	€'000		€'000
Paraja	113	Saldo fillim	10
Saldo fund	<u>5</u>	P/A	<u>108</u>
	118		118
L13		PFP	
	€'000		€'000
Saldo fillim	10,500.0	Shitjet	840.5
Teprica e rivlerësimit (L15)	418.0	P/A	1,100.0
Blerja me kredi	50.0	Saldo fund	11,250.0
Paraja	<u>2,222.5</u>		<u>-</u>
	13,190.5		13,190.5
L14		Pasuritë e paprekshme	
	€'000		€'000
Paraja	70	Saldo fund	500
Saldo fillim	<u>452</u>	P/A	<u>22</u>
	522		522
L15		Teprica e rivlerësimit	
	€'000		€'000
Fitimet e mbajtura	24	Saldo në fillim	356
Saldo fund	<u>750</u>	PFP	<u>418</u>
	774		774
L16		Dividenda e zakonshme	
	€'000		€'000
Paraja	1,800	Saldo fillim	600
Saldo fund	<u>750</u>	Fitimet e mbajtura	<u>1,950</u>
	2,550		2,550

L17 Të pagueshmet tregtare (duke përjashtuar interesin e përlllogaritur dhe të pagueshmet në lidhje me PFP)

Fillim €210,000 – €10,000 = €200,000

Fund €222,000 – €5,000 – €50,000 = €167,000

Zvogëlim = €33,000

Problemi 5

(a) Në pajtim me SNK 1 *Prezantimi i Pasqyrave Financiare*, shpjego:

- (i) komponentët e një seti të kompletuar të Pasqyrave Financiare, dhe (2 pikë)
(ii) elementet e Pasqyrave Financiare (4 pikë)

(b) Një kompani pranoi dy grante të ndara gjatë vitit nga qeveria e Shqipërisë. Granti i parë, një shumë prej €500,000 është dhënë për të blerë një impiant të rrymes, përderisa granti i dytë prej €50,000 ishte për të mbështetur trajnimin e inxhinierve të elektrikës për impiantin e rrymes. Impianti është vlerësuar se do të ketë jetë ekonomike prej 25 viteve.

Kërkohet:

Trego në detaje trajtimin e ngjarjeve të mësipërme në pajtim me SNK 20 *Kontabiliteti për Grante Qeveritare dhe Shpalosjet e Ndihmes së Qeverisë*. (4 pikë)

c) Me 1 janar 2015 Birraria Trooper sh.a bleu një makineri të re të mbushjes sipas kushteve në vijim:

	€'000	
Çmimi bazë i prodhuesit	4,200	
Zbritjet tregtare (aplikur vetëm në çmimin bazë)	20%	
Ngarkesat për transport	120	
Kostot e instalimit elektrik	112	
Trajnimi i stafit në përdorimin e makinërise	160	
Testimi para prodhimit	88	
Blerja e një kontrate për mirëmbajtje tre vjeçare	240	
Vlera e mbetur e vlerësuar	80	
		Hektolitra (HL)
Jeta e vlerësuar në hektolitra të birrave		24,000
Hektolitra të birrave të prodhuara – për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015		4,800
- për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016		7,200
- për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 (shih më poshtë)		3,400

Me 1 janar 2017, Birraria Trooper sh.a vendosi të rrisë kapacitetin e makinërisë duke i shtuar komponente të reja me një kosto prej €800,000. Kjo rritje e kapacitetit shpiu në zvogëlim të kohës së prodhimit për njësi dhe gjithashtu përmirësoi kualitetin e procesit të mbushjes. Gjithashtu rriti jetën e mbetur të vlerësuar të makinërise me 1 janar 2017 në 18,000 HL dhe vlera e saj e mbetur u rishikua në €160,000.

Kërkohet:

Pergaditi ekstraktet nga Pasqyra e të Ardhurave dhe Pasqyra e Pozitës Financiare për makinërinë më sipër për secilin nga 3 vitet deri me 31 dhjetor 2015, 2016 dhe 2017. (10 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e Problemit 5

(a)

i. Komponentët e pasqyrave financiare:

- (i) Paqyra e Pozitës financiare në fund të periudhës;
- (ii) Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për periudhën;
- (iii) Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet gjatë periudhës;
- (iv) Shënimet, që përmbajnë përmbledhje të politikave signifikante të kontabilitetit dhe informatat tjera shpjeguese;
- (v) Pasqyra e rrjedhave të parasë për periudhën;

ii. Elementet e pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare portretizojnë efektet financiare të transaksionit dhe ngjarjeve tjera duke i grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave ekonomike. Këto klasë të gjëra kanë termin "Elementet e Pasqyrave Financiare".

Elementet që ndërlidhen direkt me matjen e Pozitës Financiare në Pasqyrën e Pozitës financiare janë: Pasuritë, Detyrimet dhe Ekuiteti. Pasuritë dhe Detyrimet ndahen në qarkulluese/afatshkurtëra dhe jo-qarkulluese/afatgjata.

Elementet që ndërlidhen direkt me matjen e përfomances financiare në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse janë Të Hyrat dhe Shpenzimet.

Shpenzimet ndahen në Shpenzimet dhe Humbjet përderisa Të Hyrat në Shitjet/ Të Ardhurat/ dhe Përfitimet

(b) Granti i qeverisë – Ka dy lloje të granteve të qeverisë

E para është granti i lidhur me pasuritë, përderisa i dyti është i lidhur me të hyrat.

Granti i lidhur me pasuritë: - janë grante të qeverisë kushtet primare të së cilit janë që entiteti i kualifikuar për to duhet të blejë, ndërtoj apo në ndonjë mënyre tjetër të përvetsoj pasuri jo-qarkulluese.

Granti i lidhur me pasuri, duhet të prezantohet në pasqyrën e pozitës financiare ose

- (i) duke ndarë grantin si e hyrë e shtyer dhe amortizuar përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë ose
- (ii) duke zbritur grantin në vlerën bartëse të pasurisë.

E para prej trajtimeve të mësipërme preferohet

Prandaj granti prej €500,000 do të amortizohet me normë vjetore prej €20,000.

Granti i lidhur me të hyrat janë grante të qeverisë të tjera nga ato të lidhura me pasuritë.

Grante të lidhura me të hyrat janë:

- (i) ndonjëherë të paraqitura si kredi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse ose
- (ii) zbriten nga shpenzimet përkatëse

Nga të dy metodat më sipër e para preferohet. Prandaj granti prej €50,000 do të kreditohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si përfitim.

(c) Viti i përfunduar me 31 dhjetor	2015	2016	2017
Pasqyra e të Ardhurave	€'000	€'000	€'000
Zhvlerësimi (shih llogaritjet)	720	1,080	476
Mirëmbajtja (60,000/3 vite)	80	80	80
Trajnimi i stafit	<u>160</u>	—	—
	960	1,160	556
Pasqyra e Pozites Financiare (shih më poshtë)			
Prona, fabrika dhe pasijet			
Kosto	3,680	3,680	2,680
Zhvlerësimi i akumuluar	<u>(720)</u>	<u>(1,800)</u>	<u>(472)</u>
Vlera bartëse	2,960	1,880	2,204
Llogaritjet	€'000		
Çmimi bazë i prodhuesit	4,200		
Minus zbritjet tregtare (20%)	<u>(840)</u>		
Kosto bazë	3,360		
Ngarkesat për transport	120		
Kostot e instalimit elektrik	112		
Testimi para prodhimit	<u>88</u>		
Kosto fillestare e kapitalizuar	3,680		

Shuma e zhvlerësueshme është €3,600,000 (3,680,000 – 80,000 vlera e mbetur) dhe, bazuar në vlerësimet e jetës së makinerisë prej 24,000 hektolitra, kjo jep zhvlerësim prej €150 për hektolitër. Andaj zhvlerësimi për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 është €720,000 (€150 × 4,800 hl) dhe për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 është €1,080,000 (€150, x 7,200 orë).

Shënim: Trajnimi i stafit për përdorimin e makinerisë dhe mirëmbajtja janë të gjitha shenzime të të hyrave dhe nuk mund të jenë pjesë e kostos së kapitalizuar.

	€'000
Vlera bartëse me 1 janar 2017	1,880
Shpenzimet e mëpasme	<u>800</u>
“Kosto” e rishikuar	2,680

Shuma e rishikur ë zhvlerësueshme është €2,520,000 (2,680,000 – 160,000 vlera e mbetur) dhe me një jetë të mbetur të rishikuar prej 18,000 orëve, kjo na jep një ngarkim të zhvlerësimit prej €140 për hektolitër të birrës. Andaj zhvlerësimi për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 është €476,000 (€140 × 3,400 hl).